


ALBANIA 1



ALBANIA 2




TEKNOLOGJIA QË KA “PUSHTUAR” BOTËN

Përdorimi i shërbimeve satelitore për evidentimin e dëmeve nga zjarri

Ekspertët e ASIG, në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), me qëllim vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore nga zjarri i cili preku zonën e Peshtanit në Fier, gjatë muajit Korrik 2023, realizuan hartën e mëposhtme tematike.


Publikohet informacioni gjeohapësinor për temën “Zonat me rreziqe natyrore”




Video Informuese mbi paraqitjen 3D të ndërtesave në Gjeoportalin kombëtar

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në kuadër të projektit për krijimin e hartës bazë topografike 1:2 000, ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar paraqitjen 3D të ndërtesave për zonën urbane Tiranë, Durrës dhe Krujë.

shiko më tepër...



Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar për temën “Zonat me rreziqe natyrore”, informacionin gjeohapësinor për Hartat e rrezikut nga përmytjet për 6 basenet kryesore. **shiko më tepër...**



AKTIVITETET E KRYERA

Workshop “Përdorimi i imazheve hiperpektrale”

Me qëllim rritjen e kapaciteteve tona teknike dhe ofrimin e produkteve satelitore të një cilësie të lartë, ASIG në bashkëpunim me Satellogic, organizuan në datat 12-14 shtator, workshop-in me temë “Përdorimi i imazheve hiperpektrale”.

Konferenca Rajonale për Kadastrën dhe Infrastrukturën e të dhënave gjeohapësinore

Përfaqësues të ASIG, nga sektorët e Standardeve për Gjeoinformacionin dhe Sektori i Përpunimit të Imazheve Satelitore, morën pjesë në Konferencën Rajonale për Kadastrën dhe Infrastrukturën e të Dhënave Gjeohapësinore e cila u zhvillua në Beograd, në datat 04 - 06 Shtator 2023.

ASIG merr pjesë në Konferencën e II-të Ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit të ujit dhe zhvillimin e qëndrueshëm

Në Konferencën e II-të ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit të ujit dhe zhvillimin e qëndrueshëm-WEPSD, e cila u mbajt në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 22-23 shtator 2023, në Tiranë, morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i ASIG znj. Vilma Tomço dhe Drejtori i Drejtorisë së Përpunimit të Informacionit të Territorit me Teknologji të Avancuar, z. Dritani Prifti.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

EuroGeographics dhe ICA janë partnerë për të zgjidhur fuqinë e vendndodhjes

EuroGeographics një nga organizmat më të rëndësishëm në Evropë që ka për mision të lehtësojë zhvillimin e Infrastrukturës Evropiane të Informacionit Hapësinor duke bërë bashkë njerëzit dhe organizatat. Objektivi kryesor është të promovojë dhe lehtësojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira mes anëtarëve.

Inteligjenca gjeohapësinore fuqizon zhvillimin në fusha të shumta

Integrimi i sistemeve GIS dhe të dhënat e hartave të përfuara nga remote sensing është përshpejtuar vitet e fundit. Ndërkohë, teknologjitë e reja si modelet e AI dhe ChatGPT po shfaqen dhe po integrohen me GIS për të sjellë një vrull të ri.

GIS People prezanton libër elektronik edukativ:

GIS People ka lançuar një burim të ri të librave elektronikë të krijuar për të ofruar njohuri të vlefshme në botën e GIS. E-libri ofrohet plotësisht falas si një mjet për të nxitur edukimin dhe shkëmbimin e njohurive brenda komunitetit GIS. GIS People është një kompani e shquar australiane në fushën e sistemeve të informacionit gjeografik (GIS).

AKTIVITETE NË VIJIM

4th International Workshop on Spatial Data Quality

EuroGeographics dhe EuroSDR kanë kënaqësinë të njoftojnë një workshop mbi cilësinë e të dhënave hapësinore që do të mbahet në Qendrën Ndërkombëtare të Shoqatave, Qëllimi është të bashkojë prodhuesit, përdoruesit, akademinë për të zgjeruar debatin e vazhdueshëm mbi cilësinë e të dhënave hapësinore.

11-12 Tetor 2023

www.asig.gov.al

INSPIRE Conference 2023

Kjo konferencë vjetore synon të bashkojë komunitetin e palëve të interesuara INSPIRE për një shkëmbim mbi gjetjet fillestare të vlerësimit të ndikimit GreenData4All dhe opsionet e mundshme të politikave për evoluimin e Direktivës INSPIRE në një instrument kyç për të mbushur hapësirën e të dhënave të marrëveshjes së gjelbër me të dhëna përkatëse.

28-29 Nëntor 2023

Geospatial World Forum

Forumi Botëror Gjeohapësinor (GWF) është një platformë bashkëpunuese dhe ndërvepruese që demonstroi vizionin kolektiv dhe të përbashkët të komunitetit global gjeohapësinor. GWF është një mbledhje vjetore e profesionistëve dhe drejtuesve gjeohapësinorë që përfaqësojnë të gjithë ekosistemin e politikave publike, agjencitë kombëtare të hartografisë etj..

13-16 Maj 2024

www.geoportal.asig.gov.al